



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 46/2 prot.

Tiranë, më 27.06.2026

NJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E AUDICIONIT TË BRENDSHËM PËR POZICIONIN E LIRË TË PUNËS “SPALË SEKTORI KORI (ALTO)” PRANË DREJTORISË SË OPERËS DHE FILARMONISË

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015, Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së” si dhe në çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi për aq sa është e zbatueshme, **shpall audicionin e brendshëm për pozicionin e punës “Spalë Sektori Kori (Alto)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Të gjithë artistët e brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit deri në orën 16:30 ose të skanuar në adresën e postës elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në orën 00:00 të datës 10.06.2026 një letër shprehje interesi për pozicionin e lirë të punës.

Programi për konkurimin është:

1. Dy arie të epokave të ndryshme nga repertori operistik të përzgjedhura nga vetë konkurenti, përkatësisht nga kompozitorët: W. A.Mozart, G.Rossini, V.Bellini, G.Verdi, G. Puccini, R. Leoncavallo, P. Mascagni, J.Massenet, G. Bizet, Ch. Gounod. R. Wagner.
2. Shtrirja vokale (vokalisë).
3. Lexim me shikim të parë.
4. Repertori Koral:
 - P. Mascagni – “Cavalleria Rusticana”
“Regina Coeli” (Preghiera)

- G. Verdi – “Messa da Requiem”
“Libera me Domine” - Fugato
- G. Rossini – “Petite Messe Solennelle”
Nr. 7 “Cum Sancto Spiritu”
- F. Mendelssohn
“Elias” - Nr. 5 – “Allegro Vivace”
“Aber der Herr sieht es nicht”

5. Komisioni të vlerësojë edhe:

- Ecurinë e kandidatit duke marrë parasysh angazhimet e tij edhe si solist në produksione të ndryshme të TKOBAP-së.
- Performancën skenike si dhe etikën profesionale.
- Aftësitë bashkëpunuese me dirigjentin.
- Aftësitë drejtuese të sektorit që do të përfaqësojë.

Audicioni do të zhvillohet në datën 17.06.2026, ora 13:00, në Sallën Blu të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Shënime:

1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit, por vetëm pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të dokumentacionit.

3. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet postë elektronike zyrtare për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

